



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-031
Prishtinë, më 9 shtator 2008, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 9 SHTATOR 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa munguan Xhavit Haliti (me arsye) dhe Nexhat Daci.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini, Rita Hajzeraj dhe Zylfi Merxha.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga NDI: Rinor Bekaj dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai i propozoi edhe katër (4) pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 korrik dhe 15 gusht 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 korrik dhe 15 gusht 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 korrik dhe 15 gusht 2008, u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai propozoi që pikat e përgatitura të shqyrtohen në dy seanca të veçanta plenare.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më **18 shtator 2008**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmjetësim,
8. Shqyrtimi i Vendimit të Kryeministrit të Kosovës për emërimin e ministrit të Forcës së Sigurisë,
9. Shqyrtimi i Propozimvendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, dhe
10. Shqyrtimi i Propozimvendimit për formimin e Komisionit parlamentar ad - hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Ndërkaq, seanca tjetër të mbahet më 19 shtator 2008, me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet e Buxhetit të Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2008,
2. Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007, dhe
3. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur të Mediave për vitin 2007.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet buxhetore për tremujorin e parë dhe të dytë të Kuvendit për vitin 2008

Kryesia miratoi Raportin për shpenzimet buxhetore për tremujorin e parë dhe të dytë të Kuvendit për vitin 2008, me kërkesën e Sabri Hamitit që raportit t'i bashkëngjiten, për mbledhjen e ardhshme, pasqyrat mbi shumën e mjeteve të shpenzuara për fushën e Diplomacisë Parlamentare, si dhe shumën e mjeteve të pashfrytëzuar për këtë destinim.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për marrjen e masave administrative ndaj zyrtarëve të lartë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Agjencisë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit vlerëson punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe kërkon nga ajo që ta zbatojë Ligjin kundër korrupsionit.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Këshillit të Përgjithshëm të SNSD-Kosova, Dragana Maksimovq lidhur me pagesën e mjeteve për financimin e partisë politike

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e kryetares së Këshillit të Përgjithshëm të SNSD , nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet sekretari i Kuvendit që të bëjë konsultimet e nevojshme me OSBE-në në Prishtinë për të shqyrtuar dhe propozuar zgjidhjen lidhur me kërkesën e SNDS-së për ndarjen – pagesën e mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së ish-deputetit, Xhelal Canziba, për dhënien e ndihmës financiare për shërim jashtë vendit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e ish-deputetit, Xhelal Canziba , nxori këtë

R E K O M A N D I M

Kryesia e Kuvendit vlerëson lart kontributin e ish – deputetit Xhelal Canziba gjatë dy legjislativave të mëparshme dhe shpreh gatishtëri për t’i ndihmuar në situatën në të cilën ai gjendet. Por, në mungesë të mjeteve nga ndonjë linjë buxhetore për këtë destinim, i **rekomandohet** Ministrisë së Shëndetësisë që t’ia kompensojë shpenzimet e shërimit ish – deputetit Xhelal Canziba nga Fondi i mjeteve të destinuara për shërimin e pacientëve jashtë vendit.

3.5 Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit

Kryesia shqyrtoi kërkesat për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit dhe vendosi që t’ua lejojë dhe kompensojë mëditjet për udhëtime jashtë vendit këtyre parashtruesve: deputetit **Esat Brajshori** i lejohet qëndrimi zyrtar në Gjermani prej 3 deri më 7 shtator 2008 dhe i kompensohen mëditjet; **anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian** u lejohet udhëtimi zyrtar në Belgjikë prej 7 deri më 8 tetor 2008 dhe u kompensohen mëditjet; **anëtarëve të Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor** u lejohet udhëtimi zyrtar në Kroaci prej 22 deri më 25 shtator 2008 dhe u kompensohen mëditjet sipas vendimit të Kryesisë nr. 02-2242-1/06.

Kryesia debatoi edhe për mënyrën dhe kriteret e lejimit të udhëtimeve jashtë vendit dhe lidhur me këtë nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta hartojë një propozimvendim, në bazë të debatit të zhvilluar, mbi kushtet dhe kriteret e udhëtimit jashtë vendit dhe t’ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit në mbledhjen e ardhshme, për miratim.

5. Të ndryshme

5.1 Kryesia konfirmoi vendimin për lejimin e mjeteve të pagesës për stafin e bufesë, të shërbimit shëndetësor dhe të mirëmbajtjes konform vendimit nr 03/ 086/ DO-411 dt. 8 korrik 2008.

5.2 Kryesia u njoftua me Raportin e Komisionit për Integritet Evropian për vizitat e realizuara në Kroaci dhe në Shqipëri.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 15: 25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale